



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4221 Prot

Vlorë, më 20.03 2024

PROJEKT – VENDIM
Nr. _____, datë _____. 2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 92, DATË 24.11.2023 “PËR MIRATIMIN E
NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË,
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA – 2024”**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 64 pika c të Kreut X, VKM nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKB nr. 100 datë 29.12.2023, “Për miratimin Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2024” dhe VKB nr. 92, datë 24.11.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara – 2024”;

VENDOSI:

1. Të bëhet ndryshimi në pikën 4 të VKB-së nr. 92 datë 24.11.2023, si më poshtë:

Krijimin e dy pozicioneve Nëndrejtor/Përgjegjës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike me klasë dhe shtesë për pozicion sipas tabelës.

| Pozicioni | Klasa | Shtesa për pozicion |
|-----------------------|-------|---------------------|
| Nëndrejtor/Përgjegjës | IIIA | 80,300 |
| Nëndrejtor/Përgjegjës | IIIA | 80,300 |

2. Fondi i pagave për këto ndryshime do të pasqyrohet në Buxhetin shtesë të Bashkisë Vlorë 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha

Konceptoi: L. Brinja

K. Mali

D. Demiri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4221 prot.

Vlorë, më 20.03 2024

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 92, DATË 24.11.2023 "PËR MIRATIMIN E
NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË,
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA – 2024"**

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b, të Kreut III, neni 54 pika ç dhe dh, Kreu IX, neni 64, pika a, b, c, ç dhe d të Kreut X, është kompetencë e Këshillit Bashkiak miratimi i numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë dhe i nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me projekt vendimin e paraqitur në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, ju informojmë se:

Në pikën 1 të këtij projektvendimi është paraqitur krijimi i dy pozicioneve Nëndrejtor në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike referuar relacionit të ardhur nga kjo ndërmarrje me nr. 259 prot datë 19.03.2024, hyrë në Bashki me nr. prot datë 19.03.2024.

Për arsye të numrit të lartë të shërbimeve (shërbimet publike, pastrimi, gjelbërimi dhe mirëmbajtja e varrezave, sektori i DDD, sektori i bordit të kullimit) që ofron Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe të numrit të punonjësve, për menaxhimin dhe kryerjen sa më mirë të këtyre shërbimeve është menduar riorganizimi i kësaj ndërmarrje.

Në këto kushte, Bashkia Vlorë i drejtohet Këshillit Bashkiak me këtë Projekt-Vendim "Për një ndryshim në VKB nr. 92, datë 24.11.2023 "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024"

Ju faleminderit!

KRYETAR

Ermal Dredha

Konceptoi: L. Brinja

K. Mali

D. Demiri





4152

19.03.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

nr. 259 prot.

Vlorë, më 19.03.2024

Lënda: Kërkesë për riorganizim të ndërmarrjes

KRYETARIT TË BASHKISË
Vlorë

Bazuar në VKB nr. 92 datë 24.11.2023 "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024" dhe në Strukturën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, ju paraqesim këtë kërkesë për një riorganizim të ndërmarrjes me qëllim menaxhimin sa më të mirë të shërbimive dhe funksioneve që kjo ndërmarrje kryen. Në Strukturën tonë janë të përfshirë sektori i shërbimit të mirëmbajtjes (në të cilin përfshihen rrugë, trotuare, sinjalistike mirembajtje plazhi, mbetje të ngurta), sektori i gjelbërimit, sektori i DDD, sektori i bordit të kullimit, sektori i pastrimit dhe sektori i mirëmbajtjes së varrezave. Të gjitha këto shërbime nuk mund të menaxhohen vetëm nga një drejtues.

Për këtë arsye ju drejtohem me këtë kërkesë për rishikimin e strukturës dhe riorganizimin e ndërmarrjes.

DREJTORE

ERINOLDA LUSHAJ

